



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

NJËSIA E HARTIMIT TË DOKUMENTAVE TË TENDERIT

Nr. _____ prot.

Himarë , më ____ . ____ .2026

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “NDËRTIMI I SHKALLËVE PËR TE GJIMNAZI ‘SPIRO
GJIKNURI”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shkallë
-7441200-3, Punime ndërtimi - 45210000-2**

**VLERA E FONDIT: 6 005 546,7 (gjashtë milionë e pesë mijë e pesëqind e dyzet e gjashtë presje
shtatë) Lekë pa TVSH**

Përlllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike është kryer nga inxhinierë të licensuar referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj)”, Inxhinieri është mbështetur në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga organet kompetente, e cila duhet të përfshijë kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- NP-1 A – Punime gjurmimi në tokë;
- NP-2 – Ndërtime civile dhe industriale

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zërave të preventivit që, në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit, merr përsipër të realizojë.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë, të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (ose ministrisë kompetente të kohës) në Republikën e Shqipërisë, referuar VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”, nenin 39, pika 6, gërma (a), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se: “6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”, Ligjin Nr. 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë 10.09.1998 të ndryshuar, VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores

për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar.

Në bazë të liçencës profesionale të shoqërisë tregohet aftësia teknike e profesionale e realizimit të kontratës që prokurohet dhe pikat e kërkuara të liçensës janë përcaktuar nga vlera e punimeve që do të realizohen si dhe nisur nga natyra e punëve që do të kryhen sipas zërave të preventivit. Nisur nga fakti që vlera e objektit është më e vogël se 20 milion lekë për kategoritë e punimeve, është zgjedhur niveli i klasifikimit ”A” që i përgjigjet kësaj vlere.

Kërkesa për paraqitjen e liçencës profesionale të shoqërisë është vendosur në përputhje me legjislacionin në fuqi për liçencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari ndërtimi dhe ka për qëllim të garantojë që operatori ekonomik disponon kapacitetin ligjor, profesional dhe teknik për realizimin e punimeve objekt kontrate.

Kategoria NP-1 A – Punime gërmimi në tokë kërkohet, pasi zbatimi i këtij objekti përfshin ndërhyrje të drejtpërdrejta në terrenin ekzistues për përgatitjen e bazamentit ku do të ndërtohet struktura e shkallëve. Ndërtimi i shkallëve nuk kufizohet vetëm në realizimin e elementeve të dukshme të strukturës, por kërkon paraprakisht përgatitjen e sipërfaqes së punimeve, hapjen e gropave të themeleve, realizimin e bazamentit mbështetës dhe sistemimin e terrenit përreth.

Në kuadër të realizimit të punimeve do të nevojiten punime gërmimi sipas kuotave dhe përmasave të përcaktuara në projektin teknik, largimi dhe transportimi i materialeve të dala nga gërmimet, nivelimi i sipërfaqeve të punës, si dhe mbushja dhe ngjeshja e shtresave të tokës për garantimin e stabilitetit të konstruksionit. Këto procese janë të domosdoshme për krijimin e një baze të qëndrueshme dhe të sigurt për themelet dhe elementët mbajtës të shkallëve.

Duke qenë se shkallët e jashtme që do të ndërtohen për hyrjen në Gjimnazin “Spiro Gjicknuri” do të jenë një strukturë e përdorshme çdo ditë, qëndrueshmëria e terrenit dhe realizimi korrekt i punimeve të tokës kanë rëndësi të veçantë për sigurinë dhe jetëgjatësinë e objektit.

Kategoria NP-2 – Ndërtime civile dhe industriale kërkohet pasi objekti përbën një vepër ndërtimore civile, e cila konsiston në realizimin e një strukture të re funksionale që do të shërbejë si element aksesit për godinën ekzistuese të institucionit arsimor.

Realizimi i shkallëve të jashtme përfshin punime konstruktive dhe ndërtimore që lidhen me realizimin e themeleve, elementeve mbajtëse, strukturës së shkallëve, punimeve në betonarme dhe të gjitha proceseve të tjera të nevojshme për krijimin e një objekti të qëndrueshëm dhe të sigurt. Punimet përfshijnë ndërtimin e bazamentit dhe strukturës mbajtëse, realizimin e shkallareve dhe elementeve konstruktive sipas projektit, si dhe punimet përfundimtare të nevojshme për funksionalitetin dhe paraqitjen e objektit.

Për shkak të funksionit që do të ketë kjo strukturë, është e domosdoshme që punimet të realizohen nga një operator ekonomik i cili zotëron liçencën për ndërtime civile dhe industriale, pasi kjo kategori mbulon veprimtaritë që lidhen me realizimin e strukturave ndërtimore, punimet konstruktive, elementet prej betonarmeje dhe punimet përmbyllëse të një vepre civile.

Kategoritë e licencave të kërkuara lidhen drejtpërdrejt me natyrën e punimeve dhe janë vendosur në respektim të parimit të proporcionalitetit, pasi nuk kërkojnë liçenca për punime që nuk do të realizohen në kuadër të kësaj kontrate.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar duhet të paraqesë liçencën profesionale për kategoritë e punimeve që merr përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit, duke garantuar që çdo pjesë e kontratës të ekzekutohet nga një subjekt i liçencuar për punimet përkatëse.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të kryejnë ekuivalentimin e licencave profesionale të lëshuara në vendin e origjinës pranë ministrisë përgjegjëse në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me VKM nr. 42, datë 16.01.2008, duke siguruar respektimin e legjislacionit shqiptar dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës...”; nenin 43 pika 2/c dhe pika 3, nenin 55 pika 4 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar ku parashikohen se:

“2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme”.

“3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor”.

“Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve

të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”*. Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr. 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: *“Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”*.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron është vendosur konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për:

- një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 29 % e vlerës së përllogaritur të kontratës dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 95 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së kryer.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së kryer, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore si dhe me situacionet e punimeve dhe akt-kolaudimin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se *“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në

njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ku parashikohet se ”Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: a) Për kontratat e punëve:

i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 29 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar dhe për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 95 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore, për muajin Qershor 2026, prej minimalisht 10 (dhjetë) personash.

Kriteri do të vërtetohet me:

a) vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore;

b) listëpagesa e punonjësve, të konfirmuar nga autoritetet përkatëse, të shoqëruara me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Për dokumentacionin provues zbatohen përcaktimet e nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se ”4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se „6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë një fuqi punëtore minimale prej 10 (dhjetë) punonjësish është përcaktuar mbi bazën e analizës së preventivit të punimeve, natyrës së proceseve ndërtimore

dhe organizimit minimal të nevojshëm të kantierit për realizimin e kontratës brenda afatit prej 4 muajsh.

Referuar preventivit, objekti i prokurimit përfshin punime të ndryshme civile, betonarmeje, metalike dhe elektrike, të cilat nuk mund të realizohen nga i njëjti grup punonjësish dhe në shumë raste zhvillohen paralelisht.

Në fazën fillestare të punimeve është i nevojshëm angazhimi i 3 punonjësve, ku 2 punonjës kryejnë punimet e prishjes së shtresave të betonit, gërmimet me krah, sistemimin e materialeve dhe ndihmojnë në gërmimet me eskavator, ndërsa 1 punonjës kryen transportin manual të materialeve, furnizimin e kantierit dhe largimin e inerteve. Këto procese zhvillohen paralelisht dhe nuk mund të realizohen nga një numër më i vogël punonjësish pa ndikuar në ritmin e punimeve.

Pas përfundimit të fazës së gërmimeve fillojnë punimet e betonarmesë, të cilat përfshijnë vendosjen e 4 ton hekur betoni, realizimin e kallëpeve dhe hedhjen e 45 m³ beton C20/25. Për realizimin korrekt të këtyre proceseve kërkohen minimalisht 3 punonjës, konkretisht dy punonjës për armimin dhe montimin e kallëpeve dhe një punonjës për betonimin, vibrimin dhe sistemimin e betonit. Duke qenë se këto procese kërkojnë koordinim të vazhdueshëm dhe respektim të parametrave teknikë, ato nuk mund të realizohen nga një ekip më i vogël.

Në vijim zhvillohen punimet metalike, të cilat përfshijnë montimin e 103 ml korimano metalik, 67 ml rrjetë metalike të galvanizuar dhe bazamenteve metalike. Për realizimin e këtyre punimeve kërkohen minimalisht 2 punonjës, pasi montimi, nivelimi, saldimi dhe fiksimi i elementëve metalikë kryhen domosdoshmërisht nga një ekip prej të paktën dy personash për arsye teknike dhe sigurie në punë.

Njëkohësisht me punimet civile dhe metalike realizohen edhe punimet elektrike, të cilat përfshijnë vendosjen e elektrodave të tokëzimit, pusetave elektrike, paneleve TU, kablllove, tubave fleksibël dhe ndriçuesve. Për këto procese nevojitet të paktën 1 elektrikist, i cili duhet të disponojë njohuritë profesionale për realizimin e instalimeve elektrike sipas projektit.

Në fazën përfundimtare të kontratës realizohen punimet e veshjes me gur, të cilat kanë një volum prej 367 m², si dhe punimet e sistemimit përfundimtar të objektit. Për shkak të sipërfaqes së konsiderueshme dhe nevojës për respektimin e cilësisë së vendosjes së gurit, kërkohen minimalisht 2 punonjës, të cilët kryejnë njëkohësisht përgatitjen e sipërfaqeve, vendosjen e gurit dhe përfundimin e detajeve të punimit.

Në përmbledhje, organizimi minimal i kantierit rezulton si më poshtë:

- 3 punonjës për prishje, gërmime dhe transport;
- 3 punonjës për armim dhe betonim;
- 2 punonjës për punime metalike;
- 1 punonjës për instalimet elektrike;
- 1 punonjës për punimet përfundimtare dhe sistemimin e objektit.

Në total rezultojnë 10 punonjës, të cilët përfaqësojnë minimumin e nevojshëm për zhvillimin normal të proceseve të punës dhe realizimin e kontratës brenda afatit prej 4 muajsh.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky numër rrjedh nga analiza e volumeve të punimeve të parashikuara në preventiv, organizimi teknik i kantierit dhe nevoja për zhvillimin paralel të proceseve kryesore të punës.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë personelin teknik, të përfshirë në licencën

e shoqërisë dhe që figuron në listëpagesat e shoqërisë, si më poshtë:

- 1 (një) inxhinier ndërtimi;
- 1 (një) inxhinier elektrik;

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomë, kontratë pune, CV dhe librezë pune. Disponimi i personelit teknik të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Për dokumentacionin provues zbatohen përcaktimet e nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”, në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Kërkesa që operatori ekonomik pjesëmarrës të disponojë personelin teknik, konkretisht 1 (një) inxhinier ndërtimi dhe 1 (një) inxhinier elektrik, është vendosur në funksion të garantimit të realizimit të punimeve sipas projektit të zbatimit, specifikimeve teknike, standardeve të ndërtimit dhe legjislacionit teknik në fuqi. Ky kriter lidhet drejtpërdrejt me natyrën e objektit të prokurimit dhe është proporcional me kompleksitetin e punimeve që do të realizohen.

Objekti i kontratës konsiston në ndërtimin e shkallëve për te Gjimnazi "Spiro Gjicknuri", punime të cilat nuk kufizohen vetëm në ndërtimin e strukturës së shkallëve, por përfshijnë edhe punime të konsiderueshme betonarmeje, punime metalike, instalime elektrike dhe punime përfundimtare. Referuar preventivit të punimeve, objekti përfshin prishjen e shtresave ekzistuese të betonit, gërmime me krah dhe me mjete mekanike, transport materialeve dhe inertes, realizimin e shtresave mbajtëse me zhavorr dhe çakëll, furnizimin dhe vendosjen e 4 tonëve hekur betoni, realizimin e 45 m³ beton monolit C20/25, montimin e 103 ml korimano metalik, 67 ml rrjetë metalike të galvanizuar, bazamente metalike, kanalizime në beton, si dhe veshje me gur në një sipërfaqe prej 367 m². Këto

punime përbëjnë elementë konstruktivë dhe arkitektonikë të objektit dhe kërkojnë kontroll të vazhdueshëm teknik gjatë të gjitha fazave të zbatimit.

Për këtë arsye, prania e një inxhinieri ndërtimi është e domosdoshme për të garantuar organizimin teknik të kantierit, kontrollin e zbatimit të projektit, verifikimin e cilësisë së materialeve, kontrollin e punimeve të armimit dhe betonimit, respektimin e dimensioneve dhe kuotave të projektit, mbikëqyrjen e montimit të elementëve metalikë dhe kontrollin e cilësisë së punimeve përfundimtare. Duke qenë se shkallët janë elemente që ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë e përdoruesve të objektit, kontrolli teknik i realizimit të tyre nga një inxhinier ndërtimi është i domosdoshëm për të garantuar stabilitetin, qëndrueshmërinë dhe funksionalitetin e veprës.

Njëkohësisht, preventivi parashikon edhe realizimin e një sërë punimesh elektrike, të cilat përfshijnë furnizimin dhe vendosjen e elektrodave të tokëzimit, montimin e paneleve elektrike, pushtave elektrike, kabllave, përcjellësve, tubave fleksibël mbrojtës, ndriçuesve dekorativë LED dhe kuadrit elektrik të furnizimit. Këto punime përbëjnë instalime elektrike që duhet të realizohen në përputhje me projektin elektrik dhe standardet teknike në fuqi, pasi lidhen drejtpërdrejt me sigurinë e instalacionit dhe të përdoruesve të objektit. Për këtë arsye, është e nevojshme që operatori ekonomik të disponojë një inxhinier elektrik, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të projektit elektrik, kontrollin e vendosjes së kabllave dhe elementëve të instalimit, verifikimin e sistemit të tokëzimit, kontrollin e montimit të ndriçuesve dhe kuadrit elektrik, si dhe kryerjen e verifikimeve teknike përpara vënies në funksion të instalimit.

Kërkesa për disponimin e një inxhinieri ndërtimi dhe një inxhinieri elektrik është plotësisht proporcionale me natyrën e kontratës, pasi objekti përfshin dy disiplina të ndryshme teknike që kërkojnë kompetenca profesionale të specializuara. Kërkesa që këta specialistë të jenë të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të figurojnë në listëpagesat e saj synon të garantojë se operatori ekonomik disponon realisht kapacitetin teknik për realizimin e kontratës dhe nuk mbështetet në angazhime formale vetëm për efekt të procedurës së prokurimit.

Për sa më sipër, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kërkesa për disponimin e 1 (një) inxhinieri ndërtimi dhe 1 (një) inxhinieri elektrik lidhet drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe është e nevojshme për garantimin e cilësisë dhe sigurisë së punimeve.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë personelin teknik dhe punonjësit e nevojshëm për realizimin e kontratës, të cilët duhet të jenë të kualifikuar sipas profileve përkatëse dhe të rezultojnë të punësuar pranë operatorit ekonomik, sipas legjislacionit në fuqi.

Për realizimin e punimeve objekt prokurimi, operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht personelin e mëposhtëm:

- 2 (dy) betonues
- 1 (një) hekurkthyes
- 1 (një) murator
- 1 (një) karpentier
- 1 (një) teknik ndërtimi
- 1 (një) elektrikist
- 1 (një) eskavatorist (i cili mund të disponohet nga OE edhe nëpërmjet kontraktimit).
- 1 (një) shofer

Disponimi i personelit të mësipërm deklarohet nga operatori ekonomik në Formularin Përmbledhës

të Vetëdeklarimit. Për dokumentacionin provues zbatohen përcaktimet e nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Operatori ekonomik i renditur i pari paraqet dokumentacionin provues, si më poshtë:

- a) Kontratat individuale të punës, të vlefshme sipas legjislacionit në fuqi;
- b) Listëpagesat e sigurimeve shoqërore (E-Sig), për muajin Qershor 2026, ku të rezultojë punësimi i personelit të kërkuar;
- c) Për operatorët e mjeteve, dëshmi të aftësisë profesionale ose leje drejtimi të kategorisë përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi.

Për operatorët e mjeteve të rënda, dëshmitë e aftësisë profesionale duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuara në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi për përdorimin e makinerive të rënda të ndërtimit.

Në rast se mjetet e kërkuara janë marrë me qira nga persona fizikë ose juridikë dhe shoqërohen me operatorët përkatës, drejtuesit e mjeteve që vihen në dispozicion së bashku me mjetet nuk është e nevojshme të figurojnë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues. Në këtë rast, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin që provon disponimin e mjetit dhe të operatorit të tij, sipas marrëveshjes së qirasë ose kontratës përkatëse.

Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit operatori ekonomik deklaron për operatorët e mjeteve: emrin dhe mbiemrin, profilin e punës, datën e kontratës së punës ose të marrëveshjes përkatëse, numrin e dëshmisë së aftësisë profesionale dhe afatin e vlefshmërisë së saj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar ku parashikohet se "4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës" dhe nenin 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar, ku parashikohet se „6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit" si dhe VKM Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", Urdhërin Nr. 109, datë 05.08.2013 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit".

Kërkesa për disponimin e personelit teknik dhe të punonjësve të specializuar është përcaktuar në funksion të natyrës, vëllimit dhe kompleksitetit të punimeve objekt kontrate, me qëllim garantimin e realizimit të tyre sipas projektit, specifikimeve teknike dhe afateve të përcaktuara në dokumentet e

tenderit. Numri dhe profilet e kërkuara janë vlerësuar duke analizuar proceset konkrete të punës të parashikuara në preventiv dhe nevojën për zhvillimin paralel të aktiviteteve në kantier.

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë personelin teknik dhe punonjësit e specializuar sipas profileve të përcaktuara është vendosur në funksion të garantimit të realizimit të punimeve në përputhje me projektin, specifikimet teknike, standardet e ndërtimit dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi. Objekti i kontratës përfshin një gamë të gjerë procesesh ndërtimore, betonarmeje, metalike dhe elektrike, të cilat kërkojnë angazhimin e personelit të kualifikuar sipas profileve përkatëse.

Kërkesa për 2 betonues është vendosur duke marrë në konsideratë volumin e punimeve të betonarmesë. Preventivi parashikon realizimin e 45 m³ beton monolit, punime të cilat kërkojnë përgatitjen e sipërfaqeve, hedhjen, vibrimin, nivelimin dhe kurimin e betonit. Për shkak të volumit të betonit dhe nevojës që procesi i betonimit të kryhet në mënyrë të pandërprerë për të garantuar cilësinë dhe homogjenitetin e strukturës, angazhimi i dy betonuesve përbën minimumin e nevojshëm teknik.

Kërkesa për 1 hekurkthyes lidhet drejtpërdrejt me furnizimin dhe vendosjen e rreth 4 tonëve hekur betoni. Ky proces përfshin prerjen, përkuljen, përgatitjen dhe montimin e armaturës sipas projektit konstruktiv. Duke qenë se armatura përbën elementin kryesor mbajtës të strukturës së betonarmesë, këto punime duhet të realizohen nga punonjës të kualifikuar dhe me përvojë në këtë profil.

Kërkesa për 1 murator është e lidhur me realizimin e shtresave mbajtëse, sistemimin e bazamenteve, kanalizimeve në beton dhe veçanërisht me punimet e veshjes me gur në sipërfaqe prej 367 m², të cilat kërkojnë përgatitjen e bazës, vendosjen e materialit, fugatimin dhe përfundimin e elementëve arkitektonikë sipas specifikimeve teknike. Për shkak të sipërfaqes së konsiderueshme dhe rëndësisë që këto punime kanë në funksionalitetin dhe pamjen përfundimtare të objektit, prania e një muratori të kualifikuar është e domosdoshme.

Kërkesa për 1 karpentier lidhet me realizimin e kallëpeve të betonit, të cilat janë të domosdoshme për ndërtimin e elementëve monolitë të shkallëve. Cilësia e kallëpeve ndikon drejtpërdrejt në dimensionet, formën, nivelimin dhe cilësinë përfundimtare të strukturës së betonit. Për këtë arsye, këto punime duhet të realizohen nga një punonjës i specializuar në punime karpenterie.

Kërkesa për 1 teknik ndërtimi është vendosur për të garantuar organizimin e përditshëm të kantierit, ndjekjen e procesit të punimeve, koordinimin ndërmjet grupeve të punës, kontrollin e zbatimit të projektit në terren dhe evidentimin e situacioneve të punimeve. Tekniku i ndërtimit përfaqëson lidhjen ndërmjet drejtimit teknik dhe fuqisë punëtore, duke siguruar që punimet të zhvillohen sipas grafikut dhe kërkesave teknike.

Kërkesa për 1 elektrikist lidhet me punimet elektrike të parashikuara në preventiv, të cilat përfshijnë vendosjen e elektrodave të tokëzimit, pusetave elektrike, paneleve TU, kablllove, përcjellësve, tubave fleksibël, shtyllave dekorative të ndriçimit LED dhe kuadrit elektrik të furnizimit. Këto punime duhet të realizohen nga personel i kualifikuar për të garantuar funksionimin e sigurt të instalimeve dhe respektimin e standardeve elektrike në fuqi.

Kërkesa për 1 eskavatorist lidhet me realizimin e gërmimeve mekanike prej 20 m³, si dhe me sistemimin e terrenit sipas projektit. Përdorimi i makinerive të rënda kërkon operatorë të pajisur me dëshmi të aftësisë profesionale, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim garantimin e sigurtisë gjatë punës dhe realizimin korrekt të proceseve të gërmimit.

Kërkesa për 1 shofer është vendosur duke marrë në konsideratë nevojën për transportin e vazhdueshëm të materialeve të ndërtimit, largimin e materialeve të dala nga prishja, furnizimin e kantierit me beton, hekur, gur, materiale elektrike dhe elementë metalikë. Organizimi i punimeve

kërkon disponimin e një drejtuesi mjete për të garantuar vijueshmërinë e furnizimit të kantierit dhe respektimin e grafikut të punimeve.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se numri dhe profilet e kërkuara janë rezultat i analizës së volumeve të punimeve të parashikuara në preventiv dhe proceseve teknike që duhet të realizohen gjatë ekzekutimit të kontratës. Çdo profil profesional lidhet drejtpërdrejt me zëra konkretë të preventivit dhe përfaqëson minimumin e nevojshëm për realizimin e punimeve në përputhje me projektin dhe standardet teknike.

Kërkesa që ky personel të rezultojë i punësuar pranë operatorit ekonomik, të provohet nëpërmjet kontratave individuale të punës, listëpagesave të sigurimeve shoqërore dhe dokumentacionit përkatës profesional synon të garantojë që operatori ekonomik disponon realisht kapacitetet njerëzore për realizimin e kontratës dhe nuk mbështetet në burime njerëzore të padisponueshme në momentin e ekzekutimit të saj. Për operatorët e mjeteve të rënda dhe shoferët, kërkesa për dëshmi të aftësisë profesionale ose leje drejtimi sipas legjislacionit në fuqi është e domosdoshme për të garantuar përdorimin e sigurt dhe ligjor të makinerive dhe mjeteve që do të angazhohen në kantier.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet, makineritë dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e kontratës, në pronësi ose me qira, të përshtatshme për natyrën dhe volumin e punimeve objekt prokurimi, si më poshtë:

<i>Nr.</i>	<i>Lloji i mjetit/makinerisë</i>	<i>Statusi</i>	<i>Sasia</i>
	<i>Ekskavator ose miniekskavator</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>	<i>1 copë</i>
2	<i>Kamion vetëshkarkues</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>	<i>1 copë</i>
3	<i>Kamionçinë</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>	<i>1 copë</i>
4	<i>Betoniëre</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>	<i>1 copë</i>
5	<i>Vibrator betoni</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>	<i>1 copë</i>
6	<i>Fadromë</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>	<i>1 copë</i>
7	<i>Gjenerator</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>	<i>1 copë</i>
8	<i>Matrapik</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>	<i>2 copë</i>

Disponimi i mjeteve, makinerive dhe pajisjeve deklarohet në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Për dokumentacionin provues zbatohen përcaktimet e nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Operatori ekonomik i renditur i pari paraqet dokumentacionin provues si më poshtë:

Për mjetet që regjistrohen në regjistrat publikë:

- lejen e qarkullimit;*
- certifikatën e kontrollit teknik;*
- policën e sigurimit të vlefshme;*
- dokumentacionin që provon disponimin e mjetit.*

Për mjetet e marra me qira:

- kontratën e qirasë ose marrëveshjen e disponimit;*
- dokumentacionin e pronësisë së mjetit;*
- dokumentacionin ligjor të mjetit sipas përcaktimeve të mësipërme.*

Për makineritë dhe pajisjet që nuk regjistrohen në regjistra publikë:

- dokumentacionin që provon pronësinë ose disponimin e tyre.

Në rast se mjetet e rënda vihen në dispozicion së bashku me operatorët përkatës, operatorët e tyre nuk është e nevojshme të figurojnë në listëpagesat e operatorit ekonomik, por duhet të provohen nëpërmjet kontratës së qirasë ose marrëveshjes së disponimit dhe dokumentacionit përkatës të operatorit.

Operatori ekonomik duhet të disponojë gjithashtu pajisjet minimale të mbrojtjes dhe sigurisë në punë, në përputhje me legjislacionin për sigurinë dhe shëndetin në punë, konkretisht:

- 3 kuti të ndihmës së shpejtë;
- 5 tabela sinjalistike të përkohshme;
- 10 helmeta mbrojtëse;
- 10 jelekë fosforeshentë;
- 4 fikëse zjarri të lëvizshme.

Disponimi i këtyre pajisjeve deklarohet në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari paraqet dokumentacionin provues përkatës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

Nëpërmjet kësaj kërkesë, operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kane në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Lloji dhe numri i mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës është përcaktuar duke u bazuar në zerrat e preventivit dhe specifikimeve teknike. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të preventivit. Përcaktimi i paisjeve dhe makinerive është bërë duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” (ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), si dhe hapësirat fizike rreth objektit, mundësive të manovrimit me mjete të rënda, urbanizimit për efekt të zhurmave dhe ndotjes etj.

Kërkesa për disponimin e mjeteve, makinerive dhe pajisjeve është përcaktuar në funksion të natyrës, vëllimit dhe kompleksitetit të punimeve objekt kontrate, me qëllim garantimin e realizimit të tyre

sipas specifikimeve teknike, projektit dhe afateve të zbatimit. Mjetet dhe makineritë e kërkuara përfaqësojnë kapacitetin minimal teknik të nevojshëm për realizimin e punimeve të parashikuara në preventiv, i cili përfshin punime gërmimi, transporti të materialeve, shtresa rrugore, punime betoni dhe betonarmeje, punime hekuri, ndërtim tombinosh, sinjalistikë horizontale dhe vendosje të parrakëve metalikë.

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë mjetet, makineritë dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e kontratës është vendosur në funksion të garantimit të ekzekutimit të punimeve sipas projektit, specifikimeve teknike dhe afatit kontraktor prej 4 muajsh. Mjetet dhe makineritë e kërkuara janë përcaktuar pas analizës së preventivit të punimeve dhe përfaqësojnë minimumin e nevojshëm për realizimin e proceseve ndërtimore të parashikuara.

Kërkesa për disponimin e 1 ekskavatori ose 1 miniekskavatori lidhet drejtpërdrejt me realizimin e gërmimeve mekanike prej rreth 20 m³, sistemimin e terrenit, formimin e bazamenteve dhe ngarkimin e materialeve të dala nga gërmimi. Pranimi alternativ i ekskavatorit ose miniekskavatorit i jep operatorit ekonomik mundësinë të zgjedhë mjetin më të përshtatshëm sipas kushteve të kantierit dhe hapësirave të punës, pa kufizuar konkurrencën. Ky mjet është i domosdoshëm për realizimin e gërmimeve në mënyrë të sigurt dhe brenda afatit të kontratës.

Kërkesa për 1 kamion vetëshkarkues lidhet me transportin e materialeve të dala nga prishja dhe gërmimet, si dhe me furnizimin e kantierit me zhavorr, çakëll, gur, beton, elementë metalikë dhe materiale të tjera ndërtimi. Referuar preventivit, kontrata përfshin transport të konsiderueshëm materialesh, ndaj disponimi i një kamioni vetëshkarkues është i nevojshëm për garantimin e vijueshmërisë së punimeve dhe shmangien e ndërprerjeve gjatë ekzekutimit.

Kërkesa për 1 kamionçinë është vendosur për transportin e materialeve me volum më të vogël, veglave të punës, pajisjeve, elementëve elektrikë, personelit teknik dhe furnizimeve të përditshme të kantierit. Ky mjet është i domosdoshëm për organizimin logjistik të punimeve dhe mbështetjen e vazhdueshme të aktivitetit në kantier, veçanërisht në një objekt me punime të kombinuara civile, metalike dhe elektrike.

Kërkesa për 1 betoniere lidhet me realizimin e punimeve të betonit dhe llaçit që kërkohen gjatë ndërtimit të shkallëve, bazamenteve, elementëve ndihmës dhe punimeve përfundimtare. Edhe në rastet kur betoni kryesor mund të furnizohet nga impiantet e betonit, betoniere është e nevojshme për përgatitjen e sasive të vogla të betonit dhe llaçit në kantier, duke garantuar vazhdimësinë e punimeve dhe cilësinë e tyre.

Kërkesa për 1 vibrator betoni lidhet drejtpërdrejt me realizimin e 45 m³ beton monolit të parashikuar në preventiv. Vibrimi i betonit është një proces teknik i detyrueshëm për eliminimin e boshllëqeve të ajrit, rritjen e kompaktësisë së betonit dhe garantimin e rezistencës mekanike të strukturës. Mungesa e këtij mjeti do të ndikonte drejtpërdrejt në cilësinë dhe jetëgjatësinë e elementëve konstruktivë.

Kërkesa për 1 fadromë lidhet me sistemimin e terrenit, shpërndarjen dhe nivelimin e shtresave të zhavorrit dhe çakëllit, ngarkimin e materialeve dhe organizimin e kantierit. Duke qenë se preventivi parashikon realizimin e shtresave mbajtëse dhe transport të materialeve inerte, disponimi i një fadrome përbën një kërkesë të arsyeshme dhe proporcionale me natyrën e punimeve.

Kërkesa për 1 gjenerator është vendosur për të garantuar furnizimin me energji elektrike të pajisjeve dhe makinerive të kantierit në rastet kur furnizimi nga rrjeti elektrik nuk është i disponueshëm ose ndërpritet gjatë zhvillimit të punimeve. Gjeneratori siguron funksionimin e pandërprerë të vibratorit

të betonit, matrapikëve, veglave elektrike dhe pajisjeve të tjera të nevojshme për realizimin e kontratës, duke shmangur vonesat në ekzekutimin e punimeve.

Kërkesa për 2 matrapikë lidhet me punimet e prishjes së shtresave ekzistuese të betonit dhe realizimin e kanalizimeve në beton, të cilat janë të parashikuara në preventiv. Disponimi i dy matrapikëve mundëson zhvillimin paralel të punimeve të prishjes dhe kanalizimeve, duke rritur efikasitetin e punës dhe duke respektuar afatin e realizimit të kontratës.

Përveç makinerive dhe mjeteve të punës, operatori ekonomik duhet të disponojë edhe pajisjet minimale të mbrojtjes dhe sigurisë në punë, në përputhje me kërkesat e legjislacionit për sigurinë dhe shëndetin në punë. Kërkesa për 3 kuti të ndihmës së shpejtë është vendosur për të garantuar ndërhyrjen e menjëhershme në rast aksidentesh gjatë zhvillimit të punimeve. Kërkesa për 5 tabela sinjalistike të përkohshme lidhet me nevojën për të sinjalizuar zonat e punës, hyrjet në kantier dhe rreziqet e përkohshme, duke qenë se punimet zhvillohen në ambientet e një institucioni arsimor ku qarkullojnë nxënës, personel dhe vizitorë. Kërkesa për 10 helmata mbrojtëse dhe 10 jelekë fosforeshentë është përcaktuar në përputhje me numrin minimal prej 10 punonjësish të kërkuar për realizimin e kontratës, me qëllim që çdo punonjës të jetë i pajisur me mjetet individuale të mbrojtjes gjatë gjithë kohës së punës në kantier. Kërkesa për 4 fikëse zjarri të lëvizshme është vendosur për të garantuar ndërhyrjen e menjëhershme në rast zjarri gjatë përdorimit të pajisjeve elektrike, punimeve të saldimit dhe makinerive të ndërtimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen nga zjarri.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se makineritë, mjetet e punës dhe pajisjet e sigurisë të kërkuara lidhen drejtpërdrejt me natyrën, volumin dhe kompleksitetin e punimeve objekt prokurimi, janë të domosdoshme për realizimin e kontratës sipas projektit dhe afatit të përcaktuar dhe përfaqësojnë minimumin e nevojshëm teknik.

Specifikimet teknike, relacioni teknik, preventivi i punimeve, vizatimet teknike, profilet karakteristike, detajet konstruktive dhe grafiku i ekzekutimit të punimeve për objektin "Ndërtimi i shkollëve pranë Gjimnazit "Spiro Gjikhuri"" janë hartuar nga projektuesi i licencuar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, legjislacionin në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, aktet nënligjore në fuqi për projektimin dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit, standardet shqiptare dhe europiane të projektimit dhe ndërtimit, si dhe me rregullat e praktikës së mirë inxhinierike.

Objekti i investimit konsiston në ndërtimin e shkollëve të reja që do të shërbejnë për aksesin dhe lëvizjen e sigurt të nxënësve, stafit pedagogjik dhe përdoruesve të tjerë në ambientet e Gjimnazit "Spiro Gjikhuri". Investimi është konceptuar për të përmirësuar funksionalitetin e infrastrukturës ekzistuese, për të garantuar sigurinë e qarkullimit të këmbësorëve dhe për të eliminuar problematikat që lidhen me pjerrësinë e terrenit dhe amortizimin e elementeve ekzistuese.

Hartimi i projektit është bazuar në analizën e gjendjes ekzistuese të terrenit, në studimin e kushteve topografike dhe funksionale të zonës, si dhe në nevojën për ndërtimin e një strukture të qëndrueshme, rezistente dhe me jetëgjatësi të lartë. Për këtë arsye, dokumentacioni teknik përmban të gjitha elementet e nevojshme për realizimin korrekt të punimeve, duke përfshirë përshkrimet teknike, dimensionet, detajet konstruktive, materialet që do të përdoren, mënyrën e zbatimit të çdo procesi ndërtimor dhe standardet që duhet të respektohen gjatë ekzekutimit të kontratës.

Preventivi është hartuar mbi bazën e matjeve reale të projektit dhe përfshin të gjitha kategoritë e punimeve të nevojshme për realizimin e plotë të objektit, konkretisht:

- a) punime prishjeje dhe largimi të elementëve ekzistues;
- b) punime dheu dhe gërmime për realizimin e themeleve dhe sistemimin e terrenit;
- c) transportin, ngarkimin dhe depozitimin e materialeve të dala nga gërmimet;
- d) realizimin e nënshtresave dhe shtresave mbajtëse në territorin e ndërtesës;
- e) punime me hekur betoni për armimin e themeleve, mureve mbajtëse dhe trupit të shkallëve;
- f) punime betoni dhe betonarmeje për themelet, bazamentet, muret mbajtëse, platformat dhe elementët konstruktivë të shkallëve;
- g) punime elektrike dhe sinjalistike për ndriçimin, furnizimin me energji elektrike, kuadrot elektrike dhe elementët e nevojshëm të sinjalistikës;
- h) furnizimin dhe montimin e kuadrove elektrike dhe aksesorëve përkatës;
- i) punime metalike për korimanot dhe elementët mbrojtës;
- j) punime veshjeje me gur vendor për shkallët, platformat dhe sipërfaqet e projektuara;
- k) punime për sistemimin përfundimtar të territorit dhe pastrimin e kantierit.

Çdo zë i preventivit është analizuar në mënyrë të detajuar dhe është mbështetur në projektin teknik, duke përcaktuar sasitë reale të punimeve, njësitë matëse dhe karakteristikat teknike të materialeve që do të përdoren. Preventivi përfaqëson bazën ekonomike mbi të cilën operatorët ekonomikë do të hartojnë ofertat e tyre financiare dhe garanton që të gjitha ofertat të jenë të krahasueshme mbi të njëjtën bazë teknike.

Specifikimet teknike janë hartuar në mënyrë që të përshkruajnë qartë karakteristikat minimale të materialeve, pajisjeve dhe proceseve të punës, duke garantuar që objekti të realizohet sipas parametrave të projektimit dhe standardeve të cilësisë.

Materialet e ndërtimit, si betoni, çeliku i armimit, materialet e shtresave mbajtëse, guri natyror vendor, elementët metalikë, kabllot elektrike, kuadrot elektrike dhe pajisjet e tjera, duhet të jenë të certifikuar sipas standardeve përkatëse dhe të shoqërohen me dokumentacionin që provon cilësinë dhe konformitetin e tyre.

Në mënyrë të veçantë, për shkak të funksionit publik të objektit dhe përdorimit të përditshëm nga një numër i konsiderueshëm nxënësish dhe personeli, projektuesi ka parashikuar përdorimin e materialeve me rezistencë të lartë mekanike dhe ndaj kushteve atmosferike, duke garantuar jetëgjatësinë e investimit dhe minimizimin e kostove të mirëmbajtjes në të ardhmen.

Punimet e betonarmesë janë projektuar në përputhje me ngarkesat që do të përballojë objekti gjatë përdorimit, ndërsa punimet e hekurit të betonit janë dimensionuar sipas kërkesave statike të projektit për të garantuar qëndrueshmërinë dhe sigurinë strukturore të shkallëve dhe elementëve mbajtës.

Punimet e veshjes me gur vendor nuk kanë vetëm funksion estetik, por edhe funksion mbrojtës ndaj konsumimit mekanik dhe faktorëve atmosferikë. Përzgjedhja e gurit vendor është bërë duke marrë në konsideratë karakteristikat fiziko-mekanike, rezistencën ndaj konsumit, integrimin arkitektonik me objektin ekzistues dhe jetëgjatësinë e materialit.

Punimet elektrike janë projektuar për të garantuar ndriçimin e nevojshëm të shkallëve dhe elementëve të aksesit, duke rritur sigurinë gjatë përdorimit, veçanërisht gjatë orëve me ndriçim të kufizuar. Kuadrot elektrike, kabllot, tubacionet mbrojtëse dhe pajisjet e sinjalistikës janë përzgjedhur në përputhje me standardet teknike dhe kërkesat e sigurisë elektrike.

Vizatimet teknike dhe detajet konstruktive janë hartuar në një nivel të tillë detajimi që mundësojnë interpretimin e njëjtë nga të gjithë operatorët ekonomikë dhe nga stafi mbikëqyrës i punimeve. Ato përmbajnë të gjitha dimensionet, seksionet, prerjet, profilet, detajet e armimit, elementët metalikë dhe zgjidhjet teknike të nevojshme për realizimin korrekt të kontratës.

Grafiku i ekzekutimit të punimeve është hartuar duke marrë në konsideratë varësinë teknologjike ndërmjet proceseve të ndryshme të punës, kohën e nevojshme për realizimin e secilit proces, periudhat e maturimit të betonit, organizimin e kantierit dhe faktin që punimet do të zhvillohen pranë një institucioni arsimor në funksion. Organizimi i punimeve synon minimizimin e ndikimit në aktivitetin e shkollës, garantimin e sigurisë së nxënësve dhe respektimin e afatit kontraktor.

Dokumentacioni teknik është përgatitur në mënyrë që të sigurojë një kuptim të plotë dhe të njëjtë të objektit të prokurimit nga të gjithë operatorët ekonomikë, duke shmangur paqartësitë, interpretimet subjektive apo kufizimet e konkurrencës. Specifikimet teknike janë formuluar mbi baza funksionale dhe performancash, pa favorizuar marka, prodhues apo teknologji të caktuara dhe, në çdo rast kur referohen standarde ose produkte specifike, ato duhet të kuptohen të shoqëruara me shprehjen "ose ekuivalente", në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik.

Hartimi i këtij dokumentacioni është bërë në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, si dhe me nenin 40 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, të cilat përcaktojnë se specifikimet teknike duhet të garantojnë akses të barabartë për operatorët ekonomikë, të mos krijojnë pengesa të pajustificuara për konkurrencën dhe të përshkruajnë në mënyrë të qartë karakteristikat teknike dhe funksionale të objektit të prokurimit.

Njëkohësisht, dokumentacioni teknik është hartuar duke respektuar parimet e përcaktuara në nenin 2 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", konkretisht parimet e transparencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit, konkurrencës efektive dhe përdorimit me efektivitet, ekonomikitet dhe eficiencë të fondeve publike.

Në përfundim, Autoriteti Kontraktor vlerëson se specifikimet teknike, preventivi, relacioni teknik, vizatimet, profilet dhe grafiku i punimeve përbëjnë një dokumentacion teknik të plotë, të argumentuar dhe të mjaftueshëm për zhvillimin e procedurës së prokurimit. Ky dokumentacion krijon kushte të barabarta për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, mundëson përgatitjen e ofertave të krahasueshme dhe garanton që kontrata të realizohet sipas standardeve të kërkuara të cilësisë, sigurisë, funksionalitetit dhe qëndrueshmërisë, duke mbrojtur interesin publik dhe duke siguruar përdorimin efektiv të fondeve publike.

NJËSIA E PROKURIMIT